

Shtyhet Thirrja e Dytë për Bursa për Stafin Akademik për Mësimdhënie të Universitetit të Tiranës në Programin Erasmus + në Universitetin e Pavia, në Itali.

Në kuadër të programit Erasmus + është shtyrë thirrja e dytë për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Pavia, në Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie, 5 ditë plus 2 ditë udhëtim

Fushat e studimit:

- Matematikë, Fizikë dhe Shkencat e Natyrës;
- Ekonomiks;
- Drejtësi;
- Gjuhë të Huaja dhe Filozofi;
- Shkenca Politike;
- Psikologji;
- Studime Komunikimi.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e Nevojshme për Aplikim:

- Kandidati i interesuar përzgjedh një pedagog nga departamenti respektiv në Universitetin e Pavia për të shprehur interesin për të kryer një periudhë shkëmbimi duke dërguar përmes e-mail CV e tij/saj për të treguar fushën e ekspertizës dhe sesi të dy universitetet mund të përfitojnë nga ky aktivitet. Ju mund të gjeni të dhënat e kontaktit në adresën <http://www.unipv.eu/site/en/home/research/departments.html>
- Kandidati duhet të plotësojë dokumentin “Mobility agreement/Teaching programme” duke u konsultuar me pedagogun e përzgjedhur mbi aktivitetet që do të zhvillojë gjatë periudhës së shkëmbimit.
- Kandidati duhet të plotësojë aplikimin online në adresën <https://unipavia.pandaform.com/pub/wotpz/new>

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Dokumenti “Mobility agreement (teaching programme) i firmosur nga aplikanti dhe departamenti i Universitetit të Pavia dhe Universiteti i Tiranës***;
- Një kopje të dokumentit të identifikimit (pasaportë);
- Vërtetim punësimi në Universitetin e Tiranës.

*** Dokumenti Mobility agreement/teaching programme *për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyri gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj si dhe nga Universiteti i Pavis.*

Për të shkarkuar formatin e Mobility agreement/teaching programme ju lutemi vizitoni: <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus-overseas/teaching-staff.html>

Afati për aplikim: deri më datë 12 Shkurt 2017 (ora 12pm, sipas orës së Italisë)

Per te aplikuar ju lutemi vizitoni:

<https://unipavia.pandaform.com/pub/wotpz/new>

Gjithë aplikimi është online.

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni:

<http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus-overseas/teaching-staff.html>

ose kontaktoni me Znj. Elena Fontana në adresën: erasmusoverseas@unipv.it

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin Tuaj.